

28 NËNTOR 1912

Nga Mustafa Tërnici

Njeriu është krijuar për të jetuar i lirë dhe i pacenuar. Ai në vetvete është një qenie sociale që ka nevojë të jetojë, veprojë, të marrë e të japë brenda një bashkësie me të drejta të plota. Liria pra është një e drejtë themelore që i përket çdo kujt. Nga liria e individit rrjedh dhe sovraniteti i një kombi. Çdo bashkësi, popull apo shtet duhet të gëzojë të drejtën për të vendosur në mënyrë të lirë dhe të pavarur çështjet dhe fatet e veta. Data e 28 nëntorit ne muslimanëve shqiptarë na kujton pikërisht këtë thelb. Na kujton lirinë dhe sovranitetin, për të cilat duhet të falënderojmë Zotin tonë, Allahun e Lartësuar, i Cili na bëri të mundur të gëzojmë lirinë e të jetojmë të pavarur. Allahu i Madhëruar në Kuranin Famëllartë na përmend mirësitë e mëdha, që iu kishte dhënë Kurejshëve, banorëve të Mekës. Ai iu kishte garantuar atyre të udhëtonin të lirë gjatë dimrit dhe gjatë verës. U kishte garantuar ushqim dhe siguri. Ata pra, ishin të lirë dhe të pacenuar. Vërtet këto të dyja janë mirësi të mëdha, vlerën e të cilave e kuptojnë vetëm njerëzit e privuar prej tyre.

Vendi dhe kombi ynë është cenuar padrejtësisht shumë herë në historinë e tij dhe ka kaluar vërtet drama të dhimbshme. Madje në shumë raste është vënë në pikëpyetje identiteti i tij kombëtar, derisa sot më në fund po shijojmë këtë liri të brishtë. Muslimanët shqiptarë e ndiejnë dhe e kuptojnë shumë mirë rëndësinë dhe domosdoshmërinë e lirisë, sepse përveç ferrit të diktaturës komuniste, që iu kishte hequr lirinë e fjalës ata qenë privuar për më keq nga liria e besimit. A ka krim më të

tmerrshëm, se të ndalosh njeriun të falënderojë lirshëm Zotin e tij. A ka padrejtësi më të madhe se të çrënjosësh virtytet e larta fetare dhe morale? Vërtet privimi nga e drejta e fjalës, besimit dhe cenimi i të drejtave themelore të njeriut është robërim dhe skllavërim. Kalifi i drejtë musliman, Omer ibn Hattabi thotë: "Që kur i robëruar njerëzit kur ata kanë lindur të lirë nga nënat e tyre?!..."

Feja islame na mëson se të drejtat e njeriut janë të shenjta dhe se liria e njeriut është e pacenuar. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: "Në të vërtetë, Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit: ua kemi bërë të mundur që të udhëtojnë (lirshëm) në tokë dhe në det, iu kemi dhënë ushqime të mira e të lejuara dhe i kemi ngritur lart mbi shumë prej krijesave." (Isra 70.) Feja islame përveç se garanton të drejtat dhe lirinë e njerëzve, ajo fiton për zhdukjen e skllavërisë. Për herë të parë me shfaqjen e Islamit bota njohu bujarinë dhe shpirtgjersinë e muslimanëve për të liruuar skllavin nga robëria me vullnet të lirë pa asnjë përfitim. Për këtë arsye liria për muslimanin është aq e shtrenjtë.

Andaj edhe ne si muslimanë për çdo vit 28-29 nëntori, dita e pavarësisë dhe e çlirimit na kujton mirësinë e madhe të lirisë, gjë për të cilën duhet falënderuar Allahu i Lartësuar. Këto data na kujtojnë mundin e madh të të parëve tanë, që dhanë aq shumë për këtë vend. Na kujton sakrificat, veprat, heroizmat dhe shërbimin e palodhur të patriotëve tanë. Na kujtojnë mençurinë dhe mundin e çmuar të hoxhallarëve të shquar shqiptarë, që ndihmuan dhe nënshkruan pavarësinë e Shqipërisë dhe të shtetit të saj të parë.

100 VJET SHTET SHQIPTAR

Nga ana tjetër duhet të ndërjegjësohemi e të kuptojmë drejt realitetin e pavarësisë sonë si popull. Ndaj kujt e fituam ne pavarësinë? Kush kishte cenuar lirinë tonë dhe kush kërkonte asimilimin tonë? Po të shikohen faktet historike me objektivitet do të vërejmë, që pavarësinë e parë ne si komb e kemi fituar me shfaqjen e osmanëve në Ballkan, gjë e cila shënoi fundin e sllavizimit të shqiptarëve, asimilimit të tyre dhe garantimin e ruajtjes së identitetit tonë kombëtar. Shqiptarët në trvat e tyre para ardhjes së osmanëve kanë kaluar në shumë sundime, si ai bizantin, venedikas, bullgar, serb etj. Shqiptarët jo vetëm që nuk gëzonin autonomi të plotë, por vazhdimisht ishin nën procesin e asimilimit fetar dhe etnik. Për shembull në kohën e car Dushanit, kur ai u shpall car i serbëve dhe i grekëve, shqiptarët nuk përmendeshin askund, sepse konsideroheshin si barinj shtetës, të cilët s'kishin të drejtë përfaqësimi etnik.

Faktet historike dëshmojnë, se osmanët nuk i robëruan shqiptarët, siç përflitet rëndom në shumë libra të historisë. Përkundrazi në ndryshim nga sundimet para-osmane trvat shqiptare u futën nën zgjerimin e Perandorisë Osmane me të drejta të plota. Shqiptarët filluan të gëzonin privilegje në politikë. Më pas me përfaqimin e Islamit nga shumica e shqiptarëve filloi zgjerimi demografik i tyre në aspektin kulturor, fetar dhe politik, gjë e cila nuk përkon me zgjedhën osmane të pretenduar, as me politikën e sundimit, apo pushtimit të një vendi ose kombi. Madje më vonë një pjesë e mirë e Ballkanit, që nga Greqia e deri afër Bosnjës ra në duart e pashallarëve shqiptarë. Ndërkohë në kohën para se të vinin osmanët trvat shqiptare po përjetonin një shpërbërje territoriale dhe kolonizim të tokave të tyre me sllavë. Kurse vetë shqiptarët ishin duke u asimiluar gradualisht, duke vënë në pikëpyetje serioze identitetin e tyre etnik. Rreziku i asimilimit dhe i sllavizimit të shqiptarëve u shfaq sërisht me Luftën e Parë Ballkanike. Shtetet e aleancës ballkanike me sulmet e rufeshme kundër Perandorisë në Ballkan synuan përzënien e turqve nga Ballkani. Këto luftëra u bënë edhe shkaku i fillimit të shpërbërjes së Perandorisë Osmane, e cila u plotësua edhe me Luftën e Parë Botërore. Që para fillimit të Luftës Ballkanike, e cila nisi më 8 tetor 1912 Porta e Lartë mendonte ta ruante Shqipërinë si shtet autonom në kuadër të saj. Kështu menduan dhe shpresuan shumica e shqiptarëve,

mirëpo në momentin që plasi lufta ballkanike dhe u pa se lufta po humbiste në favor të serbëve dhe grekëve, Porta e Lartë i dha dritën jeshile shqiptarëve të merrnin në dorë frenat e trojeve të veta. Kjo ishte e vetmja mënyrë për të shpëtuar çfarë të mundej nga pushtimet e aleancës ballkanike. Vetë aleanca i shikonte trvat shqiptare si plaçkë lufte, që mund të bëhej çfarëdo me to. Aleanca synonte copëtimin e trojeve shqiptare dhe pasi pushtuan shumicën e tokave shqiptare kërkonte me çdo kusht shkombëtarizimin dhe asimilimin e shqiptarëve. Në viset shqiptare filloi të zbatohet konvertimi i fesë me dhunë. Masakrat serbe ishin nga më të dhunshmet, duke vrarë pa mëshirë, gratë, fëmijët, pleqtë dhe duke djegur e rrënuar fshatrat e duke synuar një spastrim etnik të këtyre trojeve të banuara krejtësisht me popullsi shqiptare tashmë. Këto masakra u shoqëruan me shpërngulje masive të popullsisë.

Në këto kushte patriotët shqiptarë përfshirë këtu një numër të madh hoxhallarësh të shquar, kur panë se Perandoria nëpërmjet garnizoneve ushtarake të mbetura nuk mund të siguronte më mbrojtjen e shqiptarëve dhe se trojet shqiptare po copëtoheshin, ata vendosën të shpallin pavarësinë. Ismail Qemali ka qenë vazhdimisht në kontakt me kryevezirin e Perandorisë Kibrili Qamil Pasha, i cili personalisht i ka dhënë dritën jeshile shpalljes së pavarësisë. Pikërisht më 28 nëntor u nënshkrua në Vlorë akti i pavarësisë, që nënkuptonte formimin e shtetit të parë shqiptar. Me këtë synohej njohja e Shqipërisë nga fuqitë e mëdha si shtet më vete, gjë e cila do ta shpëtonte atë nga sllavizimi e greqizimi, si dhe copëtimi i trojeve shqiptare. Në këto prizëm kuptohet qartë edhe nxitimi i Ismail Qemalit për të mbërritur në Durrës përpara pushtuesve serbë, e rrugëtimi i tij i vështirë për të mbërritur në datën 28 nëntor në Vlorën e rrethuar nga anijet greke. Pra në thelb pavarësia e Shqipërisë, në kohën kur në trvat shqiptare po zhvillohej gjenocid i pastër, nuk ka lidhje me pavarësinë nga Perandoria, sepse ajo ishte vetë në shpërbërje e sipër. Pavarësia në vetvete shënoi formimin e shtetit të parë Shqiptar me të drejta të plota si shtetet fqinje, si dhe frenimin e procesit të tyre pushtues, asimilues e shkombëtarizues. E lusim Zotin e Plotfuqishëm, ta përmirësojë gjendjen e kombit tonë për më mirë dhe të na i largojë të këqijat dhe sprovat prej nesh, Kombi e Shteti ynë të përparojë e të begatojë. Amin!

Fq 4 / Refleksione islame për patriotizmin dhe fenë në 100 vjetorin e shtetit shqiptar

Nga: Justinian Topulli

Fq 5 / A po pëson rënie imazhi i Turqisë në Lindjen e Mesme?

Fq 7 / BE-ja dhe qasja ndaj menaxhimit të krizave

Nga Bledar KOMINI

Fetva / Emërtimi i fëmijëve

Pyetje:

1-Selamun Alejkum. Pyetja e ime është në lidhje me emrat mysliman dhe emrat me kuptim shqip të lejuara fetarisht, i kam disa emra e ato janë: Ejona, Vesa, Valjeta dhe dy emra që i kam nxjerr nga emrat myslimane: Rejane, Rona. Dua te di nga këto që i ceka a janë të lejuara fetarisht, dhe nëse ka mundësi nëse dini ndonjë link që është i autorizuar dhe ka emra shqip me kuptim të mire te lejuara fetarisht te ma dërgoni.

2-Dua t'i vendosi djalit një emër të vërtetë mysliman, mua me pëlqen emri ENHAR dua të di Enhar a përdoret si emër mysliman, a është i përshtatshëm si emër djali? Kuptimi ishte nga sureja El Bekare ajeti 25 që e kishte kuptimin lumenjtë në xhenet, por desha të di a përdoret si emër?

Përgjigje: Norma islame bazë në vënie e emrave është se, emri duhet të ketë kuptim të mirë në vetvete, ose të jetë emër Profeti, siç na ka porositur Dërguari i Allahut. Profeti (alejhi salatu ue selam), ai sa herë që dëgjonte ndonjë emër të shëmtuar apo me kuptim jo të mirë këshillonte apo urdhëronte që ai emër të ndërrohej me një emër me kuptim të mirë. Kjo tregon se nuk është kusht që emri të jetë emër arab, por lejohet të jetë edhe emër shqiptar që ka kuptim të mirë, si p.sh.: Bujar, Sokol, Besnik, Pajtim, etj. Përveç emrave të Profetëve, për të cilat ka nxitur Profeti (alejhi salatu ue selam) t'i përdorim, është mirë që fëmijët t'i emërtojmë edhe me emrat e sahabëve, sepse nëpërmjet tyre ringjallet kujtimi i tyre. Këto dhe emra të tjerë me origjinë arabe dhe islame janë përdorur për breza të tërë në mesin e muslimanëve. Kështu që duke

u nisur nga fakti se shumica e njerëzve sot tek ne vendosin emra të huaj, kryesisht me prejardhje perëndimore dhe të krishterë, emrat që lidhen me personazhe të historisë së Islamit, qofshin këta shqiptarë ose jo, janë një element i mirë identifikimi që tregon identitetin tonë islam dhe faktin se ne jemi muslimanë dhe kemi traditat tona fetare. Ne e kemi të ndaluar t'iu ngjajmë jomuslimanëve në traditat dhe veçoritë e tyre dhe nuk ka kuptim që fëmija mysliman të emërtohet me një emër të krishterë! Duhet pasur parasysh gjithashtu se nuk lejohet tallja me emrat e të tjerëve, sepse ato janë pjesë e identitetit të tyre.

Nuk është i saktë mendimi se emrat me prejardhje turke ose persiane, të cilat u janë imponuar shqiptarëve, janë detyrimisht emra myslimanë, sepse kjo nuk ka bazë në fenë islame. Emra të tillë gjenden me shumicë në materiale të ndryshme, ndaj për këtë arsye duhet që sa herë të lexohet ndonjë emër të verifikohet kuptimi i tij. Gjithashtu duhet të dimë se emrat nuk mund të nxirren nga fjalët Kuranit, siç vepron ndokush, duke kthyer në emër çdo fjalë që lexon në të. Edhe fjala En'har, e përmendur në Kuran, është shumësi i fjalës nehr që në shqip do të thotë lum, pra lumenj. Ky veprim nuk është zakon islam, edhe pse një emër i tillë nuk është i ndaluar, por nuk ka ndonjë kuptim domethënës të bukur, është thjesht një emër që identifikon lumin në gjuhën arabe. Allahu e di më së miri.

Komisioni i Pyetje & Përgjigjeve pranë LSH

Puna në organet e drejtësisë

Zoti i ka dërguar Profetët e Tij dhe Zi ka zbritur Librat që njerëzit të gjykojnë me drejtësi. Rruga që ata duhet të ndjekin për t'ia arritur këtij qëllimi është të gjykojnë me ligjet e Tij, sepse këto ligje mbartin drejtësinë e plotë, dhe për këtë njerëzit duhet të lënë mënjane çdo ligj që bie në kundërshtim me ligjet e Zotit, ligje që janë hartuar sipas dëshirës dhe rendeve njerëzore. Nuk lejohet të drejtohesh për gjykim në gjykatat joislame, vetëm në rastet kur nuk ka organizim tjetër të pranuar fetarisht, e që është i aftë të kthejë të drejtat dhe largojë padrejtësitë. Kërkesat në këtë rast kudo që të paraqiten duhet të jenë të drejta fetarisht, në këtë rast duhet të pranohen vetëm gjykimet që përputhen me fenë, nëse dikush fiton nga gjykimi diçka që nuk i takon, atëherë ai nuk duhet ta marrë atë, sepse vendimi që

jep gjykatësi nuk e bën haramin hallall dhe as hallallin haram, ai është thjeshtë zbulues i gjykimit dhe jo ai që e vendos atë që në themel. Pakicat islame duhet të përpiqen të shuajnë konfliktet e tyre brenda kornizave të gjykimit islam dhe të bëjnë të gjitha përpjekjet, duke ndjekur rrugët ligjore të vendeve ku ata jetojnë, të mundësojnë vënie në praktikë të gjykimeve islame, në veçanti në gjykimet që kanë të bëjnë me kodin civil. Puna në fushën e avokatisë është e lejuar, nëse avokati është i bindur se çështja që ai mbron është e drejtë dhe e lejuar fetarisht.

Burimi: <http://lamjaonline.org/2007/11/decisions-and-recommendations-of-amjas-fifth-annual-convention/> Asambleja e Juristëve Muslimanë të Amerikës

Fjetja e fëmijës në një shtrat me familjarët

Pyetje: A i lejohet djalit të flejë me nënën ose motrën e tij, nëse ai ka mbërritur moshën e pubertetit?

Përgjigje: Nëse meshkujt mbërrijnë moshën dhjetë vjeçare atyre nuk u lejohet të flenë me nënat ose motrat e tyre në të njëjtin shtrat ose mbulesë, sepse duhet të ruhet intimiteti i tyre, si dhe të shmangen shkaqet e fitnes dhe t'i mbyllet dera së keqes. I Dërguari i Allahut (alejhi salatu ue selam) ka urdhëruar që fëmijët të ndahen nga njëri-tjetri në shtrat nëse ata mbërrijnë moshën dhjetë vjeçare. Ai për këtë gjë ka thënë: "Urdhërojini fëmijët tuaj që të falen kur bëhen shtatë vjeç dhe goditini (për të falur namazin) kur bëhen dhjetë vjeç; dhe ndajini ata nga njëri-tjetri në shtrat." (Ebu Daudi nr. 495) Nga ana tjetër fëmijët që nuk kanë mbushur moshën e pubertetit janë të urdhëruar të marrin leje, kur të hyjnë në dhomë (shtëpi) në tri kohët kur të njerëzit (të rriturit) pushojnë (para sabahut, në drekë dhe në mbrëmje), sepse në këto kohë ka shumë mundësi që të rriturit të zbulojnë pjesët e turpshme të trupit (në dhomat e tyre). Allahu i Lartësuar thotë: "O besimtarë! Sklleverit dhe fëmijët tuaj që s'kanë arritur pubertetin, le t'ju kërkojnë leje (për të hyrë) në tri kohë: para namazit të mëngjesit, kur i zhvishni rrobat në mesditë dhe pas namazit të jacisë. Këto janë tri kohë kur hiqni rrobat. Nuk ka gjynah as për ju e as për ata që, pas këtyre rasteve, të vizitoni njëri-tjetrin (pa kërkuar leje për të hyrë). Kështu jua

shpjegon Allahu shpalljet juve! Allahu është i Urtë dhe i Gjithëdijshëm." (En-Nur: 58)

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar ata që kanë mbërritur moshën e pubertetit që të marrin leje në këto tri kohë kur të hyjnë në shtëpi duke thënë: "Kur fëmijët tuaj të arrijnë moshën e pubertetit, le të kërkojnë leje, ashtu siç kanë kërkuar leje ata para këtyre. Kështu jua shpjegon Allahu juve shpalljet e Tij! Allahu është i Urtë dhe i Gjithëdijshëm." (En-Nur: 59).

Të gjitha këto norma janë vendosur për të shmangur fitnen, për të ruajtur nderin dhe për t'i zënë rrugën së keqes. Fëmijët që janë nën moshën dhjetë vjeç lejohet që të flenë bashkë me nënën dhe motrën në shtratin e tyre, nëse ata kanë nevojë për përkujdesje, pasi feja nuk e shtrëngon gjykimin në një situatë të tillë, nëse ata janë të sigurt nga fitneja. Nëse ky kusht është evident, atëherë ata mund të flenë të gjithë së bashku në të njëjtin ambient, por gjithsecili në një shtrat më vete – ky gjykim vlen edhe nëse kanë mbushur moshën e pubertetit. Allahut i përket mbështetja, paqja dhe bekimet e Ti qofshin mbi Profetin tonë, Muhamedin dhe shokët e tij.

*Komisioni i Përhershëm i Fetvasë Fetva nr. 1600 v. 1404 h. / 1984 e.s
Burimi: <http://www.alifta.net/Fatawa/fatawaDetails.aspx?View=Page&PageID=1309&PageNo=1&BookID=2>*

A lejohet ta heq këtë fëmijë?

Pyetje: Jam një motër myslimane 40 vjeçare, kam 3 fëmijë dhe tashmë jam sërish shtatzënë në javët e para... Këto vitet e fundit kam pasur probleme me shëndetin dhe momentalisht ndihem shumë e dobët, gjithashtu shqetësohem për këtë fëmijë, kam frikë se gjendja ime do të rëndohet akoma më shumë në muajt në vazhdim. Unë doja të dija nga hoxha që a më lejohet ta heq fëmijën, meqë jam në ditët e para të shtatzënisë? Ju lutem të më ktheni përgjigje sa më shpejt sepse ndihem vërtet e stresuar dhe nuk di si t'ia bëj. Ju falenderoj shumë.

Përgjigje: Padyshim që ardhja në jetë e një njeriu është një ngjarje shumë e rëndësishme për familjen dhe shoqërinë. Feja Islame i ka dhënë një rëndësi madhore ruajtjes së jetës së njeriut dhe për këtë arsye ajo nuk e lejon -në parim- pengimin e shtatzanisë dhe ndërprerjen e saj, por vetëm në raste mjaft të kufizuara dhe të justifikueshme fetarisht, siç është ruajtja e jetës apo shëndetit të nënës. Një nga argumentet bazë për këtë është hadithi profetik ku thuhet: "Çdonjëri prej jush formohet në barkun e nënës së tij për dyzet ditë si ujë i pakët, pastaj për të njëjtën kohë bëhet si diçka e varur, pastaj për të njëjtën kohë bëhet si një copë mishi e shtypur, pastaj i dërgohet engjëlli dhe i fryn atij shpirtin, dhe atij i urdhërohen të shkruaj katër gjëra: të shkruaj

rrëskun dhe jetëgjatësinë e tij, të shkruaj veprat e tij dhe nëse do të jetë i humbur apo i fituar." (Buhariu & Muslimi).

Kështu që duke u nisur nga ky hadith një pjesë e dijetarëve janë të mendimit se lejohet aborti gjate dyzeteditëshit të parë, nëse gjendja fizike e nënës është e rëndë apo jo e mirë, duke pasur në këtë rast edhe lejen e bashkeshortit. Por, padyshim nëse ajo duron, kjo gjë është më e mirë, sepse ndoshta Allahu mund t'i japë miresi nga ky fëmijë, duke mos haruar faktin se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selem) ka nxitur në shtimin e myslimaneve. Ndërsa pas dyzeteditëshit të parë, pa arritur 120 ditësi, nuk lejohet aborti, vetëm për një arsye shumë të fortë, që e verteton një komision mjekësh specialistë, se asaj i rrezikohet jeta apo kur ajo ka një sëmundje të rëndë që rrezikon seriozisht shëndetin e saj. Aborti pas muajit të katërt, pra pas 120 diteve, kur i fëmijës i fryhet shpirti, dijetarët janë të një mendje se aborti nuk lejohet, vetëm në raste ekstreme kur vihet në pikëpyetje jeta ose vdekja e nënës. Aborti për shkak të varfërisë dhe pamundësisë materiale për rritjen dhe ushqimin e femijeve nuk lejohet. Allahu e di më së miri.

Komisioni i Pyetje & Përgjigjeve pranë LSH.

Oazi i shpirtit / MESAZH PËR NË VARREZA

Letër drejtuar bashkëqytetarëve të mi

Nga Bledar Tefik Haxhiu

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirë-plotit

Falënderimet qofshin vetëm për Allahun. Paqja dhe shpëtimet qofshin mbi të dërguarin Muhamed, mbi familjen e tij, si dhe mbi të gjithë pasuesit e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Bashkëqytetari im i nderuar!

Vdekja është një realitet të cilit nuk mund t'i shmangët askush. Çdo gjë dhe çdokush ka fund dhe vdekje, përveç të Gjallit të përherëshëm e të Pavdekshmit, Zotit, të Gjithëpushtetshmit.

Allahu e ka krijuar jetën dhe vdekjen për të parë se cili është më vepërmiri, ndaj njeriu ato momente jete që i kalon në këtë botë duhet t'ia kushtojë adhurimit dhe bindjes së Allahut, si dhe të kujdeset që të jetojë duke kryer vepra të mira dhe të jetë sa më i dobishëm.

Për shkak se njerëzit nuk e shmangin dot vdekjen, atëherë pikërisht ata kanë nevojë të varrosen, si shenjë nderimi dhe mirësie për ta.

Megjithatë, ne duhet të jemi të ndërgjegjshëm, se njeriu që në momentin kur vdes, ai e ndërpret çdo lidhje me këtë botë dhe aspak nuk ka mundësi të ndikojë më në të, imagjino saqë nuk mund të luajë, të kthejë përgjigje apo të veprojë ndonjë gjest që e bën i gjalli. Profeti Muhamed alejhi selam në një thënie të tij thotë: "Njeriu kur vdes, puna e tij i ndërpritet me përjashtim të tri gjërave: lëmosha e vazhdueshme që ai ka dhënë, dija e dobishme që ka shpërndarë dhe femija i mbarë i cili lutet për të".

Nisur nga kjo themi se i vdekuri ka nevojë që ne të lutemi për të, në mënyrë që Allahu t'ia lehtësojë atij gjendjen aty ku është. Por, nuk është aspak e udhës, që njerëzit të cilët vizitojnë varret, të mendojnë se të vdekurit mund të sjellin dobi apo dëm. Kjo bie në kundërshtim të

plotë me parimet e fesë islame, madje njeriu kështu të vdekurit i ka dhënë atributet e Allahut, vepër kjo tek e cila nuk duhet të bjerë askush.

Po ashtu, bie ndesh me parimet e Islamit që të gjallët të shkojnë në varre dhe t'u luten atyre, apo të ndezin qirin tek ata, apo të presin kurbane, apo të ndërtojnë mbi to tyrbe dhe mekame, duke menduar se ata kështu do t'u bëjnë dobi. Dëmi dhe dobia janë në dorë të Allahut, prandaj dhe i drejtohet njeriut me këto fjalë: "Përveç Allahut, mos iu lut tjetërkujt nga ata që nuk të sjellin as dobi, as dëm. Nëse do ta bëje këtë, atëherë, ti do të ishe vërtet keqbërës. Nëse Allahu vendos që të të godasë ndonjë e keqe, askush nuk mund të ta largojë atë, përveç Tij, e, nëse Ai do të të bëjë ndonjë të mirë, s'ka kush që ta pengojë mirësinë e Tij. Ai ia jep atë mirësi kujt të dojë prej robërve të Tij. Ai është Falës dhe Mëshirëplotë". Sure Junus, 106-107.

Ne besojmë se në jetë ka plot njerëz të

mirë, por po ashtu duhet të besojmë se ata pasi vdesin nuk mund të realizojnë më asgjë, madje as për veten e tyre, ndaj dhe nuk lejohet që ata të shenjtërohen apo madhërohen, në asnjë lloj forme dhe mënyre.

Nuk është mirë dhe as e udhës, që njerëzit të bëjnë gara se kush e bën varrin e të afërmit të tij më të madh, më të bukur apo më të kushtueshëm! Varri duhet të jetë i thjeshtë dhe ndërtimet mbi të, janë shpenzim i pasurisë dhe mundim e vështirësi për të vdekurin, i cili ndoshta i mallkon për atë se ç'bëjnë mbi varrin e tij.

Nuk është e udhës që mbi varre të vihen cigare, raki, biskota, lekë apo gjëra të kësaj natyre, sepse ato nuk i bëjnë aspak dobi të vdekurit, kush dëshiron të japë lëmoshë për të, t'ia japë në dorë fukarenjve dhe jo ta lërë tek varri.

Si një qytetar i këtij vendi, dëshiroja që ta drejtoja sinjerisht këtë mesazh, sikurse shpresoj që ai të jetë i dobishëm për ty, sepse ne jemi muslimanë dhe këto janë mësimet e fesë sonë.

DITA E ASHURES

Historia e njerëzimit është e Humbshur me beteja në mes të vërtetës dhe të pavërtetës, në mes të drejtës dhe të padrejtës, në mes të mirës dhe të ligës, në mes besimit dhe mosbesimit. Një nga këto histori për të cilën na ka folur edhe Allahu në Kuran është historia e Musait (alejhi selam) me Faraonin e Egjiptit. Allahu pasi e bëri Musain Profet dhe i ngarkoi këtë barrë të rëndë, e dërgoi atë te Faraoni, për t'i kërkuar dy gjëra. E para që ai të besonte, pra t'i largohej shirkut, mos të adhuronte tjetër kë veç Allahut dhe të mos e konsideronte veten më si Zot në mes njerëzve dhe së dyti, të lejonte Musain që të largohej me popullin e tij nga toka e Egjiptit. Por, Faraoni me mendjemadhësinë dhe arrogancën e tij nuk pranoi as njërin dhe as tjetrin, përkundrazi, i mbylli sytë para mrekullive që Allahu i tregoi nëpërmjet duarve të Musait dhe vazhdoi me shtypjen dhe dhunën që ai ushtronte ndaj popullit të Musait. Allahu atëherë e urdhëroi Musain që natën ai të merrte popullin e tij dhe të largohej nga ai vend. Musai duke iu bindur urdhrit të Zotit të tij kështu bëri. Ai organizoi popullin e tij dhe u nis për rrugë. Por, natyrisht nuk është e lehtë të udhëtosh me mijëra njerëz në një natë të vetme pa u ndjerë dhe u marrë vesh nga të tjerët. Kështu pra Faraoni me ta marrë vesh seç po ndodhte mobilizoi ushtrinë e tij që t'i vihej në ndjekje Musait dhe popullit të tij, për t'i kthyer ata mbrapsht. Në rrugë e sipër ata u gjendën përpara detit, nga ku nuk kishte rrugë tjetër ku mund të devijonin për në synimin e tyre, përpara qëndronte deti dhe pas tyre vinte Faraoni me ushtrinë e tij. Çifutët, populli i Musait, filluan t'i ankohen atij për situatën e krijuar, por ishte Allahu i Madhëruar, Ai që i kishte nxjerrë ata nga ai vend dhe jo Musai, ndaj Ai nuk kishte për t'i braktisur ata. Allahu hapi para tyre një rrugë në det, duke i ngritur valët e tij si të ishin male dhe urdhëroi Musain

dhe popullin e tij të kalonte nëpër të. Dhe kështu u bë. Faraoni nga ana e tij, që edhe njëherë tjetër po shihte me sytë e tij një nga mrekullitë e Allahut, përsëri nuk u bind, por u vu në ndjekje të tyre në mes të detit nëpër të njëjtën rrugë nga e kaloi Musai popullin e tij. Por, Allahu e mbylli këtë rrugë në det, shpëtoi Musain dhe popullin e tij dhe e mbyti Faraonin bashkë me ushtrinë që shkonte nga pas. I tillë do të jetë përfundimi i të gjithë atyre që ngrenë krye kundra Zotit të krijesave.

Kjo ngjarje ka ndodhur pikërisht në dhjetë Muharem, pra në ditën e dhjetë të muajit hënor Muharem, ndaj dhe kjo ditë quhet dita e Ashures, që në gjuhën arabe do të thotë e dhjeta, pra dita e dhjetë.

Kur Profeti (alejhi salatu ue selam) emigroi në Medinë, ai pa se çifutët agjëronin në këtë ditë, sepse Musai (alejhi salatu ue selam) e agjëronte këtë ditë, si shenjë mirënjohje ndaj Allahut. Profeti (alejhi salatu ue selam) vendosi ta agjëroj këtë ditë duke ndjekur shembullin e vëllait të tij profet, Musait dhe jo çifutët, sepse myslimanët janë më afër Musait sesa vetë çifutët, që pretendojnë se janë ndjekës të Musait. Agjërimi i kësaj ditë, siç përcillet nga fjalët e Profetit (alejhi salatu ue selam), shlyhen gjynahet e një viti më parë; që me agjërimin tonë si myslimanë të mos ngajmë me çifutët, është mirë që bashkë me ditën e Ashures të agjërojmë një ditë para ose një ditë pas kësaj dite.

Dita e Ashures është ditë agjërimi, pra ditë adhurimi dhe nuk është ditë feste dhe as ditë hidhërimi. E themi këtë sepse po në këtë ditë është vrarë padrejtësisht edhe Husejni (radijallahu anhu), nipi i Profetit (alejhi salatu ue selam), djali i Fatimesë dhe Aliut (radijallahu anhu), në vendin e quajtur Kerbela (Qerbela) duke luftuar me njerëz zullumqarë që kishin dalë ta ndalnin rrugëtimin e tij për në Kufe të Irakut dhe për ta detyruar tu nënshtrohej kërkesave të tyre. Mirëpo kjo ngjarje, tepër

e dhimbshme në historinë islame, nuk mund të shërbej për tu shndërruar në një ditë zie, apo përkujtimesh mortore. Kjo ditë nuk është ditë kur njerëzit duhet të vënë kujën dhe të gjakosen me kama dhe zinxhirë, si pendesë për një krim që nuk është kryer prej tyre. Nëse ka fatkeqësi vdekjeje më të madhe për myslimanët, ajo është vdekja e Profetit tonë (alejhi salatu ue selam), e megjithatë askush nga ne nuk e kthen këtë ditë hidhërimi në një ditë përkujtimi zie dhe skenash makabre, që të vjen turp t'i shohësh. Vdiq Ebu Bekri, Umeri, Osmani dhe Aliu u vranë nga armët gjakatare të njerëzve të padrejtë, por umeti islam nuk i shndërroi ditët e vdekjes së këtyre burrave, shumë më të rëndësishëm sesa Husejni (radijallahu

anhu), në ditë zie dhe ditë ku më shumë se asnjëherë tjetër shëmtohet imazhi i Islamit para syve të gjithë botës, nga njerëz të cilët për fat keq pretendojnë se janë ndjekës dhe dashamirës të familjes së Profetit (alejhi salatu ue selam), por që në realitet rruga e tyre është shumë larg rrugës së tyre. Por, natyrisht është po ashtu e gabuar, që si kundërshtim ndaj këtyre veprimeve që nuk gjejnë mbështetje në fenë tonë, të bëjmë të kundërtën, duke gëzuar dhe festuar! Kjo është një ditë adhurimi dhe kaq mjafton, ndërsa ngjarjet që kanë përkuar të ndodhin në këtë ditë, janë pjesë e historisë, për të cilat ne nuk mund të sajojmë dhe shpikim kremtime mortore apo festive bidat, sepse çdo bidat në fe, siç pohon Profeti (alejhi salatu ue selam) është humbje.

Edukata e selamit dhe dispozitat e tij

Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet se i Dërguari i Allahut (alejhisalatu uesselam) ka thënë: "I hipuri në mjet i jep selam këmbësorit. Këmbësori i jep selam të ulurit dhe pakica i jep selam shumicës." Transmetuan Buhariu nr 6232 dhe Muslimi nr 2160

Në një version tjetër që e shënon Buhariu nr 6231 thuhet: "Ai që është më i vogël i jep selam më të madhit, kalimtar i jep selam të ulurit dhe pakica i jep selam shumicës."

Nga Ebu Umame (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet se i Dërguari i Allahut (alejhisalatu uesselam) ka thënë: "Njeriu më me përprësi te Allahu është ai që fillon i pari me selam." Transmetuan Ebu davudi nr 5197 dhe Tirmidhiu nr 2694 dhe thotë se hadithi është i mirë.

Nga Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet se i Dërguari i Allahut (alejhisalatu uesselam) ka thënë: "Kurt ë takojë ndonjëri prej jush vëllain e tij (musliman) le t'i japë selam. Nëse mes tyre dyve bëhet pengesë një pemë, mur ose gur dhe pastaj takohen le t'i japë selam." Transmetuan Ebu Davudi nr 5200 ndërsa imam Ibn Haxheri e klasifikon hadithin si të saktë.

Analizë / Refleksione islame për patriotizmin dhe fenë në 100 vjetorin e shtetit shqiptar

Nga Justinian Topulli

Gjatë gjithë periudhës së diktaturës komuniste shqiptarë e këtij nën-qielli janë bombarduar nga një propagandë anti-fetare, e cila ndër tjera pasi e cilësonte rrejshëm shqiptarin si një indiferent shekullar ndaj fesë, nuk harronte të trillonte edhe teorinë e konspiracionit, se: fetë e ndryshme në mesin e shqiptarëve gjithmonë kanë pasur si synim të tyre të shërbenin si kolona e pestë e armikut, për t'i sunduar ata, madje, ato pikërisht për këtë qëllim janë përhapur nga pushtuesit në mesin e tyre! Pasojat e këtij edukimi të vazhdueshëm në fakt shihen edhe sot, ku mjaft njerëz të kulturuar dhe jo të tillë, të rinj dhe të vjetër, vazhdojnë ta ruajnë këtë imazh për fenë në përgjithësi dhe për Islamin në veçanti. Nëse në periudhën komuniste pesha më e madhe e agjentit të huaj binte mbi kishën dhe klerin katolik, sot ky entitet dhe këta njerëz konsiderohen si më atdhedashësit, të cilët na lidhën me Evropën "Atdheun tonë të origjinës", ndër-kohë që muslimanët dhe feja e tyre, si një subjekt që na lidh me "Azinë", me arabët dhe turqit, pra me të "huajt" dhe agjendat e tyre armiqësore dhe imperialiste! Në fakt kjo nuk është diçka e re për ne si shqiptarë. Nacionalizmi shqiptar gjithmonë ka pasur rrymat e tij, ku gjithsecila e shihte kombin shqiptar herë si vëlla me grekët e herë si armik me ta, herë si vëlla me turqit e herë si armik me ta, herë si vëlla me sllavët e herë si armik me ta, herë si vëllezër me Evropën Perëndimore e herë si armiq me të. Ndërsa sot, mesa duket, për arsye të qarta pragmatiste politike dhe ekonomike, por edhe kulturore dhe aspak historike Islami për shqiptarët konsiderohet si hallka e fundit e zinxhirëve të vargonjve osmanë, si shenjë e skllavërisë së dikurshme ndaj Lindjes (Kadare, Mosmarrëveshja, Onufri 2010). Për këtë arsye, nuk janë të paktë zërat, që ngrenë e vënë, se muslimanët në mesin e shqiptarëve janë "kopilë" të turqve dhe se ata përbëjnë një rrezik potencial sigurie për kombin dhe shtetin shqiptar. Edhe musliman, edhe shqiptar patriot, nuk mund të jesh! Vetëm nëse e shohim me këtë sy mund të kuptojmë gjithë atë urretje, që njerëz me emër dhe anonimë vjellin vrer racist mbi muslimanët shqiptarë, nëpër media elektronike e tjetërkund; vetëm nën ndikimin e kësaj fobie të injektuar, mund të kuptojmë edhe studimet dhe artikujt absurdë për ruajtjen e sigurisë kombëtare nga fundamentalizmi islamik, që përpilohen nga individë apo institucione shtetërore apo të pavarura! (Xh. Shala, A. Kullolli, I. Koçollari etj.)

Zoti e krijoi njeriun nga kjo tokë dhe e bëri atë banesën e tij në këtë botë. Këtu ai lind, ushqehet, jeton dhe vdes. Për të, kjo tokë është atdheu dhe mëmëdheu i tij i madh dhe i përbashkët, që ai e ndan me llojin e tij human dhe krijesa të tjera të Zotit, e ndërsa vendi i veçantë, ku ne kemi lindur, jemi rritur dhe jetojmë është shtëpia jonë e veçantë, që po Zoti na ka dhuruar në këtë jetë. Është në natyrën e njeriut si krijesë, që ta dojë vendlindjen dhe truallin e tij dhe të parëve të tij. Është interesant fakti, se nga kjo natyrë njerëzore buron edhe besimi në Zot, pra, nga ajo që Kurani e quan fitre.

Fitra është natyra e lindur njerëzore,

për të cilën Zoti thotë: "Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë." (Rrum: 30)

Ajeti i mësipërm na tregon se burimi i besimit vjen nga diçka e pandryshueshme e njeriut, me të cilën ai lind dhe vdes, dhe kjo është pikërisht fitra, nga e cila buron në fakt edhe dashuria e natyrshme e njeriut për vendlindjen e tij. Pra, edhe besimi, edhe dashuria për mëmëdheun takohen te një gurrë e përbashkët dhe prej tij burojnë. Për aq kohë sa do të shteret kjo gurrë, për aq kohë do të shteret edhe besimi në Zot dhe dashuria për vendlindjen. Kjo gurrë mund të ndotet apo pakësohet nga faktorë të jashtëm, por ajo kurrë nuk mund të shteret, ashtu siç edhe besimi të Zoti dhe dashuria për mëmëdheun, nuk shteren për njeriun.

Këtu ia vlen të sqarojmë se, fjala që citohet shpesh si hadith se: "Dashuria e atdheut buron nga besimi", nuk është e saktë. Së pari, kjo fjalë nuk është fjalë e Profetit (alejhi salatu ue selam), edhe pse libra të ndryshëm e citojnë atë si të tillë. Dijetarët e hadithit kanë treguar se kjo fjalë i atribuohet në mënyrë të gabuar Profetit dhe nuk është thënë prej tij. Së dyti, dashuri ndaj atdheut kanë edhe njerëz që nuk besojnë, çka përforcon edhe më shumë atë që thamë më sipër, se si besimi ashtu edhe dashuria për atdheun kanë të njëjtin burim, fitrën, por jo që detyrimisht rrjedhin nga njëra-tjetra.

Kështu pra, besimi në Zot dhe dashuria për atdheun, shkojnë për ne si besimtarë muslimanë paralelisht, pa u përplasur apo zënë vendin e njëra-tjetrës. Çdonjëra ka vendin e vet në zemrën e njeriut, ndaj është e gabuar ta vendosësh një besimtar para dilemës: nëse do më shumë fenë apo atdheun? Që të bësh një pyetje të tillë, do të thotë të vendosësh shenjë e barazimit në mes fesë dhe kombit. Pra, se feja dhe kombi kanë tipare tërësisht të njëjta, aq sa njëra mund ta zëvendësojë tjetrën (shenjë e barazimit të kombit me fenë e kanë vendosur fqinjët tonë grekë e sllavë, e cila për pasojë solli edhe sjelljet e tyre genocidale ndaj nesh). Ndërkohë që këtu na duhet të qartësojmë se ç'është kombi dhe më pas, se ç'është feja? Në fjalorin e sotëm të gjuhës shqipe kombi përkufizohet si: "Bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe të formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës." Ndërsa përkufizimi që jep Enciklopedia Britanike është: "Njerëz, të cilët kanë identitet të përbashkët dhe krijojnë një trup psikologjik dhe një komunitet politik. Identiteti i tyre politik zakonisht përmban disa karakteristika, siç janë një gjuhë e përbashkët, kulturë, etni dhe histori e përbashkët."

Ndërsa feja, nga burimi i mësipërm përkufizohet si: "Marrëdhënia e qenieve njerëzore me Zotin, apo zotat, apo çfarëdo gjëje tjetër që ata e konsiderojnë të shenjtë, e në disa raste thjesht e mbinatyrshme." Më tej, aty thuhet: "Fetë përpriqen t'i përgjigjen pyetjeve themelore, që kanë të bëjnë thëllësisht me gjendjen e njeriut, nëpërmjet marrëdhënies me të shenjtën apo të mbi-

natyrshmen, apo nëpërmjet perceptimit të natyrës së vërtetë të realitetit."

Siç shihet qartë nga këto dy përshkrime, kombi dhe feja nuk janë e njëjta gjë dhe nuk mund të vendoset shenja e barazisë, edhe pse ato në mes tyre mund të kenë elementë të përbashkët, por që të dyja padyshim janë pjesë e identitetit të njeriut. Feja ka si objekt të saj kultin, adhurimin, Hyjin, botën tjetër, shpëtimin e shpirtit, etj, ndërsa kombi (një fjalë me origjinë arabe kjo: kaum) ka atdheun, etninë, gjuhën, historinë, kulturën. Feja nuk është e kufizuar në hapësirë dhe në kohë dhe përmban përgjithësisht botëkuptime të pandryshueshme për botën, jetën dhe njeriun, ndërsa kombi është i kufizuar në hapësirë, madje edhe në kohë, e religjioni është shumë më i hershëm si pjesë e identitetit të njeriut, sesa kombi. Kështu pra, që të pyesësh se cili është identiteti yt më i rëndësishëm feja apo shqiptaria, do të thotë që ose feja është nacionalizëm, ose nacionalizmi është fe. Parimisht, asnjëra dhe as tjetra nuk janë respektivisht të tilla, por historikisht ka ndodhur që të identifikohe abuzivisht me njëra-tjetrën, ku fe të ndryshme janë shndërruar në nacionalizëm dhe kombe janë shenjtëruar si të ishin perëndi. Duket se këtë të fundit, kanë dashur ta bëjnë mjaft ideologji post mesjetare, mes tyre edhe komunizmi në Shqipëri. Mirëpo, historikisht kjo tentativë ka rezultuar një e keqe e madhe, ndaj ata njerëz, që adhurojnë diçka që nuk mund të jetë objekt kult, në fakt kanë nacionalizuar një fe të caktuar, duke e përçudnuar atë, nga një këndvështrim universal mbi botën dhe njeriun, në një racizëm të shëmtuar, ku vetëm ata janë bijtë e qiellit dhe të tjerët janë bagëti apo kanë një status më të ulët si njerëz, apo ka edhe të tillë, që kombin e kanë kthyer në fe, pasi e kanë trupëzuar më parë atë, duke e pleksur me ndonjë ideologji të shek. XIX apo XX.


Përballë kësaj panorame absurde, ne si besimtarë në Zot, natyrisht që jo vetëm ne si muslimanë, por edhe besimtarë të feve të tjera, që besojnë në një Zot të vetëm universal, do të përgjigjeshim se adhurojmë Zotin dhe jo kombin. Që të jesh atdhedashës, nuk do të thotë që patjetër të jesh ateist apo laik, siç besojnë disa që trashëgojnë akoma në këtë drejtim, një mendësi komuniste e antifetare.

Ne e duam këtë vend, sepse kjo dashuri siç e thamë më lart, buron nga i njëjti burim si edhe besimi, por edhe feja na e mëson diçka të tillë. Vetë Profeti i Zotit, Muhamedi (alejhi salatu ue selam) kur doli nga Meka, atdheu dhe vendlindja e tij, tha: "Sa vend i mirë që je ti dhe sa i dashur për mua! Nëse banorët e tu nuk do të më kishin nxjerrë, nuk

do të kisha banuar askund tjetër."

Por përveç kësaj, kjo dashuri që ne kemi për vendin tonë nuk është dashuri vetëm me fjalë, sepse vetë feja jonë na obligon në këtë drejtim, më shumë sesa fjalët dhe ndjenjat sentimentale. Vetë Profeti i Zotit, edhe pse u largua nga vendlindja e tij, u kthye përsëri në të, me një mision të madh, si një njeri që i solli mirësi këtij vendi. I tillë duhet të jetë edhe besimtari musliman, edhe nëse është larg atdheut të tij. Kontributi i tij për të, duhet të jetë në çdo hapësirë dhe mundësi që i krijohet dhe kjo natyrisht, që vjen nga dashuria dhe dëshira për ta parë vendin e tij sa më mirë. Kjo dëshirë duhet të bazohet mbi parime të drejta dhe universale, e parime më të drejta dhe më universale sesa ato që vijnë nga vetë Zoti, nuk mund të ketë. Kështu që çdo ideologji, sado nacionaliste ta tregojë veten, edhe nëse e kthen kombin në një dashuri të verbër dhe në fe, do të mbështetet mbi një mendësi të caktuar, e cila nëse nuk buron nga Zoti, jo vetëm që nuk i sjell asnjë dobi atij, por e çon vetë kombin drejt shkatërrimit. Historia është dëshmitarja më e mirë për këtë gjë, e cila tregon se ku të çon nacionalizmi i verbër, për të cilin jo më kot thuhet se "është streha e fundit e çdo maskarai".

Ne si besimtarë jemi të urdhëruar të sillemi mirë e t'i duam jo vetëm besimtarët e largët, por në radhë të parë, ata që kemi pranë. Mirësjellja dhe nxitja për t'u bërë mirë njerëzve, në Islam përshkallëzohet jo vetëm për besimtarët dhe vetëm mbi baza fetare, por edhe mbi afërsinë e gjakut, krushqisë, miqësisë dhe fqinjësisë. E atdheu ynë i vogël, por i dashur për ne, përbëhet pikërisht nga këta njerëz që i kemi ose fis, ose krushqi, ose miq, ose fqinj dhe mirësia ndaj tyre është kërkesë e fortë e besimit tonë si muslimanë. E gjitha kjo që thamë nuk është hipokrizi, që ne bëjmë në këtë njëqindvjetor të themelimit të shtetit shqiptar, por bindje dhe besim që buron nga besimi ynë si muslimanë.



Analizë / Sekretet e historisë së Alevitëve dhe shfrytëzimi i pamëshirshëm i tyre prej francezëve

Si e justifikojnë alevitë vrazhdësinë e tyre përmes përndjekjes së tyre fetare për vite me radhë?!

Revista "The Times" publikoi të premten një artikull në faqen e saj, që i përket opinioneve nën titullin "Sëkti i fshehtë zë vend në të ardhmen e Sirisë, që prej të shkuarës së saj". Në këtë artikull thuhet se alevitë mbështesin regjimin e Beshar Esedit dhe e përdorin përndjekjen fetare që iu është bërë prej shekujve për të justifikuar egërsinë e tyre sot. Në artikull thuhet tekstualisht: "Kur francezët sundonin Sirinë pas ndarjes së Lindjes së Mesme pas Luftës së Parë Botërore, ata kishin nevojë për një grup të brendshëm, ku mund të mbështeteshin, një pakicë e preferuar që t'i mbante të tjerët nën pushtet dhe që të vinte në zbatim porositë e francezëve. Francezët u drejtuan për tek alevitë, të cilët ishin pasardhësit e një sektit sirian, që karakterizoheshin nga ash-përsia, forca, paqartësia dhe që banonin nëpër male. Siria sot po paguan çmimin e politikës pushtuese të Francës "përça dhe sundo", ndërkohë që sektit alevi i Beshar Esedit mban pushtetin mes një konflikti sektar që sa vjen dhe ndizet më fort.

Zhytja e Sirisë në protesta të fuqishme dhe shtypja e përgjakshme e tyre ka ardhur pjesërisht falë historisë së alevive dhe trashëgimisë së tyre shpërthyesë prej çmendurisë së përndjekjes, fshehtësisë, frikës dhe rendjes pas pushtetit. Në pjesën më të madhe të historisë pas shkëputjes nga rryma kryesore shi'ite në shekullin e nëntë, alevitë ose nusejritë (që vjen nga emri i themeluesit të sektit Ibn Nusejri) kanë vuar prej përndjekjes fetare. Kështu, gjatë sundimit osman ata u konsideruan heretikë (qafirë) dhe perandoria i ngarkoi me taksa të shumta dhe i shtypte deri në atë masë sa ata refuzonin ta pranonin islamit sunit. T.J. Lorenci shkruan: "Ky sekt ishte tribal, përsa i përket riteve dhe politikës. Asnjë nusejri nuk mund të tradhtonte një tjetër dhe rrallë ndodhte që të tradhtonte një person jomusliman." Ky sekt e konsideron veten një degë të shiave, por doktrina e tyre mbetet ende e

rrethuar nga paqartësitë dhe parimet e tyre themelore janë ende objekt hamendjeje.

Influenca franceze në rajon hapi rrugën e ngjijtes së alevive. Franca bëri qëllimisht ndarjen e rajonit sipas linjave fetare, sociale dhe gjeografike. Alevitë, të cilët konsideroheshin si "gjak luftëtarësh" Franca i inkurajoi të futeshin në radhët e ushtrive pushtuese dhe në radhët e policisë, si forca anti-sunite dhe për të penguar përhapjen e nacionalizmit sirian. Në vitin 1922 rajoni alevit u shpall shtet, që kishte të drejtën e autonomisë nën protektoratin francez dhe deri në vitin 1942 ky rajon funksionoi në mënyrë të pavarur. Francezët kujtuan se fjala "nusejri" vjen nga fjala "nasara" i krishterë, një term islam që përdoret për të krishterët, përkatësisht "nasira", pra ndihmëtarët e Jezusit. Për këtë arsye francezët vendosën që t'ua ndryshonin emrin zyrtarisht duke i quajtur alevi, pra ndjekësit e Aliut, djali i xhaxhait të Profetit a.s. dhe dhëndri i tij.

Alevitë morën pushtetin e parisë ushtarake kur në pushtet mbërriti Hafiz Esedi pas grushtit të shtetit në vitin 1970. Pavarësisht se dy milionë alevi përbëjnë vetëm 11% të popullsisë së Sirisë (ku 75 % janë suni), kjo popullsi arriti të merrte kontrollin e shtetit dhe të monopolizonte pothuajse të gjitha postet kyçe. Teksa publikisht familja e Esedit shpallte se po pakësonte ndasitë sektare dhe se po afroheshin me pakicat e tjera fetare, që kishin frikë nga sundimi sunit, në realitet familja mbledhte bijtë e alevitëve dhe i vendoste ata në të gjitha institucionet zyrtare, në partinë Bathiste që ishte në pushtet, në shërbimet civile, në shërbimet e fshehta dhe sidomos në ushtri dhe në elitën e shërbimeve të sigurisë. Afërsisht 70% e ushtarëve siriane dhe 80% e oficerëve janë alevitë. Alevitë gjithashtu formojnë grupin e gangsterëve "Shabiha", që janë një milici që kanë përgjegjësinë për operacionet më të këqija të vrasjeve masive, siç ishte masakra më e freskët në Kubejr. Kjo milici është e përbërë pothuajse tërësisht nga bandat alevite, të cilat merren në shërbim pikërisht për të tilla krime dhe për këto vepra marrin

shpërblime të mëdha.

Familja e Esedit arriti me sukses që t'i kthente alevitë në pengje eficientë. Familja e Esedit u siguronte atyre pasuri dhe banesë për të varfrit në këmbim të besnikërisë së verbër. Sekti me regjimin qëndrojnë shumë afër njëri-tjetrit, deri në atë masë sa alevitët kanë frikë se mos rrëzimi i regjimit mund të shkaktojë një hakmarrje gjithëpërfshirëse të shumicës sunite.

Përndjekja dhe shtypja që përbënin edhe lëndën kryesore djegëse të masakrave në Kubejr, Haula, Azleh me të cilën njihet historia alevite e këtyre dy viteve të fundit dhe doktrina alevite që u krijua në shoqëri malësore tepër impulsive dhe të mbyllura, të gjitha këto së bashku përbëjnë një përzierje të pashembullt dhe të çuditshme doktrinash. Në këtë mënyrë alevitë janë një bashkim mes krishterimit, gnosticizmit, zoroastrianizmit dhe idhujtarisë fenikase. Ky sekt nuk bën thirrje për kryerjen e riteve të haxhit, as për agjërim, nuk ka xhami dhe e konsideron namazin si një rit jo të domosdoshëm. Ata ruajnë disa rite sipas traditës të krishterë, si p.sh. pirja e verës së shenjtë. Alevitë besojnë se Aliu është hyjni, por ata respektojnë një numër profetësh, duke filluar nga Ademi dhe deri te Isai, dhe këtyre u shtojnë edhe personazhe të tjerë nga trashëgimia klasike, siç është Platoni dhe perandorët persë nga periudha paraislamike!

Ndërkohë doktrina alevite është e rrethuar nga sekrete. P.sh. gratë konsiderohen si jo të denja për mësimin e fesë dhe disa çështje të doktrinës i dinë vetëm një grup i veçantë njerëzish. Ritet alevite kryhen në fshehtësi të plotë, gjë e cila është konform parimit të "tukjes", që do të thotë fshehje e besimit në mënyrë që të mos përballësh me diskriminim dhe përndjekje. Historianët tregojnë se kjo shoqëri që jeton në këtë fshehtësi përbën një tokë pjellore për shërbimet e frikshme sekrete siriane, që e kanë mbështetur regjimin që në fillimet e veta.

Të flisje për sundimin alevit ishte një çështje e ndaluar në regjimin e familjes së

Esedit, të cilët përqaftuan filozofinë laike dhe pretendonin, se nuk i njihnin sekretet fetare, por nga ana tjetër ata konsiderohen si qeveria, e cila mbështetet më së tepërmi mbi sektarizmin dhe mbi familjen në Lindjen e Mesme. Tani për tani kjo epërsi është e ekspozuar ndaj rrezikut dhe Esedi përpiqet t'u ndezë frikën alevive, në mënyrë që të mbrojë vetveten. Thuhet se Esedi ka shpërndarë armë në zonat me popullsi alevite, që gjenden në mes të popullsisë sunite dhe "Shabihave" iu janë lëshuar frerët për të sulmuar zonat, që janë të lidhura me opozitën. Vrasja sistematike e fëmijëve nga ana e regjimit ka njohur rritje nën konfliktin sektar, ashtu siç ndodhi në Bosnjë, Ruandë dhe në Gjermaninë naziste, sepse shteti sirian është përfshirë tani në luftën e spastrimit etnik. Nga ana tjetër rezistenca e armatosur siriane përpiqet të shfaqet sa më atdhetare që të jetë e mundur, duke u justifikuar se luftën kundër Esedit e udhëheqin sunitët. Këshilli Kombëtar Sirian ka në gjirin e tij rreth 331 anëtarë, ndër ta nuk ka më shumë se 20 alevi. Esedi e di mjaft mirë se shpresa për mbijetesën e tij tani për tani varet nga përçarja sektare, duke shpresuar që mundësia për ndërhyrjen e huaj të zbehet më shumë në rast përçarje mes sunitëve dhe shiave jashtë Sirisë, në Lindjen e Mesme dhe më gjerë. Sekretari i përgjithshëm i OKB-së u shpreh se Siria ka shumë mundësi të shkojë drejt luftës civile, një luftë mes tiranisë dhe forcave të ndryshimit demokratik, midis një partie të prishur dhe vrastare dhe popullsisë të mbytur në varfëri, por gjithashtu mes sekteve të ndryshme fetare, që ndahen nga njëra-tjera nga doktrina të vjetra dhe një histori e dhunshme. Shabihat (grupet e gatshme) e ndezur në maksimum, shumë vite persekutimi fetar dhe sundimi të pushtuesit, shfrytëzimi i përçarjeve dhe një vend i ndarë me forcë dhe frikë janë fantazmat që e ndjekin nga pas të shkuarën dhe të ardhmen e Sirisë.

Burimi: almokhtsar.com/node/59922

Liria e shprehjes në Islam

Asambleja e Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam, e dalë nga Organizata e Konferencës Islamike, e mbledhur në sesionin e saj të nëntëmbëdhjetë në emiratit e Sharikas (Emiratet e Bashkuara Arabe) nga 1-5 Xhumadil Ula 1430 h. / 26-30 Prill 2009 e.s, pasi mori në shqyrtim studimet e paraqitura para saj në lidhje me temën e "Lirisë e shprehjes dhe mendimit: rregullat dhe dispozitat e saj", dhe pas dëgjimit të diskutimeve që u zhvilluan rreth temës, vendosi si më poshtë:

Së pari: Me liri të shprehjes së mendimit kuptohet: Vullneti i plotë që gëzon njeriu, për të shfaqur atë që ai e mendon të saktë dhe që realizon të dobishmen për të dhe shoqërinë, qoftë kjo për çështje të veçanta apo për probleme të përgjithshme.

Së dyti: Liria e shprehjes së mendimit është një e drejtë e mbrojtur në Islam, brenë kornizave të rregullave sheriatike.

Së treti: Disa nga rregullat sheriatike më të rëndësishme në ushtrimin e lirisë së

mendimit janë:

1- Të mos cenohet dikush tjetër me diçka që prek jetën, nderin, prestigjin, reputacionin apo pozitën e tij morale, si p.sh.: ulja e figurës, përbuzja e tallja, si dhe të mos bëhet publikimi i tyre me çfarëdo mjeti.

2- Të ruhet objektiviteti, vërtetësia, paa-nësia dhe të jetë e zhveshur nga tekat personale.

3- Të mbahet përgjegjësia dhe kujdesi që respekton interesat e shoqërisë dhe vlerat e saj.

4- Mjeti i shprehjes së mendimit duhet të jetë i lejuar. Nuk lejohet shprehja e mendimit, qoftë edhe i drejtë, nëse bëhet nëpërmjet një mjeti që në të ka dëm, ose përmban cenim të nderit apo të vlerave. Qëllimi i lejuar nuk justifikon përdorimin e mjetit të palejuar.

5- Shprehja e mendimit duhet të ketë si qëllim kënaqësinë e Allahut të Lartësuar dhe t'i shërbejë interesit të myslimanëve, qoftë ky i veçantë apo i përgjithshëm.

6- Të merren në konsideratë rrjedhjat dhe pasojat që mund të shkaktohen nga shprehja e mendimit, duke respektuar kësh-tu rregullin e peshimit ndërmjet dëmit dhe dobisë, se cila është më e madhe.

7- Mendimi i shprehur duhet të mbështet në burime të besueshme dhe duhet të shmang thashethemet e përhapura, duke respektuar kështu fjalën e Allahut të Lartësuar që thotë: "O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt padashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë." (el-Huxhurat: 6)

8- Shprehja e mendimit të lirë nuk duhet të përmbajë asnjë sulm ndaj Fesë, karakteristikeve simbol të saj (sheair), dispozitave dhe shenjtërive të saj.

9- Liria e shprehjes së mendimit nuk duhet shpjerë në cenimin e rendin publik të umetit dhe të shkaktojë përçarje në mes myslimanëve.

Asambleja këshillon gjithashtu:

a- Të jepen të gjitha garancitë e mjaftueshme për mbrojtjen e lirisë së shprehjes së mendimit, liri kjo e rregulluar sipas normave të Sheriatit, si dhe të merret përgjegjësia për hartimin e ligjeve që e mbrojnë atë dhe ruajnë gjykimin e drejtë.

b- Të përdoren të gjitha mjetet në dispozicion, për të mos lejuar përdorimin e lirisë së shprehjes, si mjet për cenimin e parimeve dhe shenjtërive islame, apo për përhapjen e fitnes në mes myslimanëve.

c- Të punohet për të vënë në zbatim normat e konventave ndërkombëtare, që vendosin kufizime të cilat parandalojnë ofendimin e feve, duke qëndruar larg ambiguitetit që përdor komuniteti ndërkombëtar karshi çështjeve islame dhe çështjeve të tjera.


d- Shtetet myslimane duhet punojnë për nxjerrjen e një ligji ndërkombëtar, që mbron ndjenjat dhe shenjtëritë fetare në përgjithësi nga: ofendimet, tallja dhe shtrembërimet e tyre, qoftë kjo edhe nën petkun e artit, lirisë së shprehjes së mendimit apo diçka tjetër.

Opinion / A po pëson rënie imazhi i Turqisë në Lindjen e Mesme?

Nga Abdyllhamit Biliçi

Përse një person puna e të cilit është të përmirësojë relacionet me Mediat Arabe dhe të promovojë pozicionin e Britanisë përballë të gjitha zhvillimeve në rajon të udhëtojë për në Turqi dhe të dëshirojë të takohet me një gazetar turk? Në këtë takim të tre viteve më parë unë e pyeta diplomatit britanik, përse kishte udhëtuar për në Turqi dhe dëshironte të takonte një gazetar turk. Përgjigjja e tij ishte mbresëlënëse: "Kushdo në Lindjen e Mesme, duke përfshirë politikanë, biznesmenë, politikanë, gazetarë dhe njerëz të zakonshëm e lavdërojnë Turqinë dhe ngritjen e saj mbresëlënëse. Unë desha ta shihja këtë vend që po habit gjithkënd në rajon dhe të kuptoj se si e ka përmirësuar imazhin e saj për një periudhë të shkurtër kohore."

Kjo është diçka, që kushdo në rajonin tonë do ta vërente. Telenovelat turke po transmetohen në televizione të ndryshme nëpër të gjithë vendet e rajonit; një numër i madh turistësh arabë në rritje po vizitojnë Turqinë; biznesmenë, intelektualë dhe organizata të shoqërisë civile po njihen me njëri-tjetrin; presidenti Abdulla Gyl dhe kryeministri Recep Tajip Erdogan, po aq sa ata edhe ministri i jashtëm Ahmet Davutogllu janë të mirëpritur kudo që ata shkojnë dhe nga shumë njerëz, nga Maroku në Iran, ku Turqia po shihet si një vend model. Ky interes në rritje për Turqinë nga elitat qeverisëse dhe njerëzit e zakonshëm në këto vende evidentohet edhe më tej dhe vërtetohet nga sondazhet e brendshme dhe ndërkombëtare.



Pranvera Arabe, e cila i ndryshoi dramatikisht klishetë e zakonshme dhe modelet e marrëdhënies në rajon fillimisht e mbështeti këtë mendim konstruktiv për Turqinë. Shumë liderë që dolën gjatë këtij procesi deklaruan se kanë marrë Turqinë si shembull. Turqia mbajti anën e popullit në Tunizi dhe Egjipt, dhe kjo politikë e shpagoi atë. Turqia dha kontributin e vet po ashtu për zgjidhjen e krizës në Libi.

Megjithatë pjesa siriane e Pranverës Arabe jo vetëm që dëmtoi marrëdhëniet tona me këtë vend, por gjithashtu ndikoi për keq perceptimin e Turqisë në Lindjen e Mesme. Sondazhet e fundit publike të bëra nga Fondacioni Turk

i Kërkimeve Ekonomike dhe Sociale (TESEV) tregojnë se perceptimi i Turqisë në Lindjen e Mesme ka rënie për herë të parë. Sipas këtij sondazhi të bërë në 16 vende të Lindjes së Mesme në gusht mesatarja rajonale e atyre që kanë një këndvështrim pozitiv për Turqinë ishte 78% më 2011, por kja rënë në 69% më 2012. Me një përjashtim për Vendet e Gjirit me 1% rritje perceptimi pozitiv i Turqisë është në rënie në të gjitha vendet e sonduara. Përqindja e atyre, që kanë një këndvështrim pozitiv për Turqinë ka rënë nga 86% në 84% në Egjipt, nga 78% në 63% në Liban, nga 89% në 77% në Palestinë, nga 44% në 28% në Siri, nga 71% në 59% në Iran, nga 74% në 55%

në Irak dhe nga 91% në 80% në Tunizi.

Me përjashtim të Sirisë dhe Irakut pjesa më e madhe e popullit në vendet e rajonit vazhdojnë të kenë këndvështrimin e një miku për Turqinë. Turqia shihet gjithashtu si një vend që ka kontribuar pozitivisht në procesin e ndryshimeve në rajon. Natyrisht që kjo është e rëndësishme. Megjithatë vetëm 52% e pjesëmarrësve e shohin si korrekte politikën e Turqisë në krizën siriane, 36% e shohin si të gabuar këtë politikë. Ky sondazh nxorri se numri i atyre që ndjejnë, se ndikimi i Turqisë në rajon ka rritje, ka rënë nga 70% në 61%, ndërsa numri i atyre që besojnë se Turqia mund të shërbejë si model për Lindjen e Mesme ka rënë nga 63% në 53%.

Ajo që është më e vështirë se sa të arrish në majë është të qëndrosh atje. Gjendja aktuale na sugjeron që neve jemi në një pikë kritike në termat e ruajtjes së imazhit pozitiv të Turqisë. Imazhi përmirësuar i Turqisë në rajon ndikon në çdo aspekt të jetës, duke përfshirë këtu bumin ekonomik me një numër të madh turistësh që vizitojnë Turqinë, por është gjithashtu e vërtetë që rënia e këtij imazhi ndikon jo vetëm mbi AKP-në, por gjithashtu edhe mbi popullatën turke. Për këtë është thelbësore të njohim se në këtë problem ku një numër faktorësh ndikojnë dhe ndër to politika ndaj Sirisë dhe cilësia e komunikimit me botën arabe janë ato për të cilat duhet të merren masat e duhura.

<http://www.todayszaman.com/columnist-297729-is-turkeys-image-declining-in-the-middle-east.html>

Perspektiva perëndimore: Publiku pro-palestinez kundër qeverive pro-izraelite

Sulmet ajrore në Gaza kanë shpërthyer një seri protestash globale, të cilat kanë dënuar sulmet ndaj civilëve të pambrojtur. Të premten që shkoi bota perëndimore përjetoi protesta të fuqishme. Me mijëra njerëz kanë dalë në protesta në Lindjen e Mesme, në Perëndim dhe në Evropë për të treguar përbuzjen dhe neverinë e tyre ndaj këtyre sulmeve. Ndërkaq një pjesë e madhe qeverive të vendeve perëndimore mendojnë ndryshe dhe që Izraeli ka të drejtën e tij për t'u vetëmbrojtur. Në Romë u organizua një bisedë anti-izraelite në parlamentin italian. Organizatorët e kësaj bisede i kanë bërë thirrje bashkësisë ndërkombëtare për t'i dhënë fund masakrimit të popullit palestinez dhe të ndalojnë "makinën e luftës izraelite". Qytetet e Venecias, Palermos, Ravenës dhe Trentos

iu bashkuan Romës duke bërë secili protesta. Demonstrime të mëhershme ka pasur në Nju Jork, Çikago, Paris, Durban (Afrika e Jugut), Madrid e Sidnej duke bërë thirrje për t'i dhënë fund menjëherë sulmeve mbi palestinezët. Sulmet izraelite kanë hyrë tashmë në ditën e gjashtë dhe përshkallëzime të mëtejshme pritet të ndodhin, ndërsa pritet edhe ndërhyrja tokësore. Ushtarakë të lartë izraelitë kanë paralajmëruar që trupat janë urdhëruar të përgatiten "për gjendjen më të lartë të gatishmërisë" dhe pritet që të pushtojnë edhe Gazën këtë fundjave. Javën e kaluar kabineti izraelit ka aprovuar një draft për 75,000 ushtarë rezervistë për operacione terreni. Ndërkaq protestat anti-izraelite nëpër botë vazhdojnë, duke bërë thirrje për të dërguar menjëherë ndihma humanitare.

Faktori ndërkombëtar kërkon një armëpushim të menjëhershëm në Rripin e Gazës

Ministrat e Jashtëm të Bashkimit Evropian kërkojnë të hënën ndërprerjen e menjëhershme të sulmeve izraelite në Rripin e Gazës duke theksuar se një armëpushim do të ishte në interesin e të gjithëve. Ministrat kërkojnë ndërprerjen e menjëhershme të sulmeve izraelite në Rripin e Gazës dhe përshëndetjen misionin e sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Ban Ki-moon në rajon. "Një armëpushim është në interesin e të gjithëve", theksuan ministrat. "Nuk mund të justifikohen sulmet kundër civilëve të pafajshëm", shtuan ministrat. Bombardimet izraelite kanë shkaktuar sot më tepër se 20 të vdekur në Rripin e Gazës, ditën e gjashtë të këtij konflikti dhe numri i viktimave deri tashti llogaritet t'i ketë kaluar 100, ku ndër to ka shumë fëmijë. Presidenti rus, Vladimir Putin i bëri thirrje kryeministrit izraelit, Benjamin Netanjahu gjatë një bisede telefonike të shmangej përshkallëzimi i dhunës në Gaza, apel që ia drejtoi edhe palestinezëve, ndërkohë që vazhdon dita e sytë e një operacioni ushtarak izraelit kundër grupit të armatosur në territoret palestineze, Hamas. "Presidenti rus u

kërkoji palëve të përfshira në konflikt të tregonin vetëpërmbytje dhe të shmangnin përshkallëzimin e dhunës, ku në radhët e viktimave përfshihen edhe civilë, dhe të bënin çtë ishte e mundur që situata t'i kthehej në itinerarin e saj normal", njoftonte Kremliin përmes një deklarate, ku theksohej se "Putin kishte zhvilluar një bisedë telefonike me kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu. Në kthim nga vizita në Egjipt Kryeministri iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve në avionin qeveritar.

Në lidhje me sulmet e Izraelit Kryeministri Erdoan tha se Hamasi është i gatshëm për armëpushim, ndërsa rikujtoi thirrjen që u kanë drejtuar Amerikës dhe palëve të tjera të interesuara për "një armëpushim të njëkohshëm". Kryeministri Erdoan bëri sqarime edhe për deklaratat që kishte bërë më herët drejtuar Izraelit "bëji mirë llogaritë". Ky tha Erdoan është një rekomandim. Për momentin nuk kemi ndërmend që të acarohemi, të grindemi, të luftojmë me asnjë në rajon. Por marrëdhëniet tona me Izraelin pothuajse janë minimizuar", shtoi ai.



BE-ja DHE QASJA NDAJ MENAXHIMIT TË KRIZAVE

Nga Bledar KOMINI

Gjatë dekadës së fundit, Bashkimi Evropian e ka rritur rolin e tij në menaxhimin e krizave, si në nivel rajonal ashtu dhe në atë global. Me krijimin dhe zgjerimin e një ideje për sigurimin dhe mbrojtjen evropiane, BE ka përvetësuar dhe ngritur një grup instrumentesh dhe institucioneve në nivel operativ për menaxhimin e krizave. Duke filluar që nga viti 2003 (me UEPM në Bosnje-Hercegovinë), vit në të cilin u krijua edhe institucioni i Politikave të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët (European Security and Defence Policy), BE-ja është angazhuar në 25 konflikte, 17 prej të cilave kanë qenë civile dhe civile e ushtarake bashkë – prej tyre 12 ndërhyrje kanë qenë vetëm në vitin 2006. Modeli që ka ndjekur BE ka qenë ai i “sigurisë përfshirëse”. Ky model mbështetet jo vetëm në menaxhimin e konflikteve, por edhe në ndalimin e tyre. Ai parashikon një spektër të gjerë aktiviteti në mbështetje të paqes. Kjo qasje, e cila qëndron në themel të Strategjisë Evropiane të Sigurisë nisur në vitin 2003, është ritheksuar edhe në disa dispozita të reja të Traktatit të Lisbonës, hyrë në fuqi në 1 dhjetor 2009. Megjithatë, menaxhimi i krizave dhe ndërmarrja e operacioneve konkrete, nuk është një ambicie strategjike e BE dhe traktateve të saj. Origjina e idesë mbi krijimin e një institucioni të përbashkët evropian për menaxhimin e krizave i shtrin fillesat e saj pikërisht në vitet '90. Ishte pikërisht samiti franko-britanik i dhjetorit 1998 në Saint Malo, kur të dyja këto vende të vendosura përballë një krize ballkanike në Jugosllavi, u gjendën të papërgatitura për të reaguar. Përtej faktit se Evropa kishte mbi 2 milion ushtarë, forca të vendeve të BE-së, sërish ajo nuk arriti të gjente një konsensus për të ndërhyrë në krizën ballkanike. Të vetme vendet evropiane ishin të papërgatitura për të dhënë ndonjë kontribut, e vetmja mënyrë ishte që të kishte një reagim institucional. Vetëm në Samitin e Helsinkit të dhjetorit 1999, vendet e BE-së arritën që të binin dakord për krijimin e një kuadri institucional për Sigurinë dhe Mbrojtjen në Evropë, e cila do t'i angazhonte vendet anëtare të përfaqësoshin me 60.000 trupa ushtarake (njohur ndryshe si Helsinki Headline Goal). Ndërhyrja e parë ushtarake në formë paqeruajtëse ishte ajo në Republikën Demokratikë të Kongos, po në vitin 2003.

Në 2003 Këshilli Evropian i dha fund procesit të nisur në Helsinki edhe pse disa nga objektivat kryesore të vendosura në të nuk ishin realizuar. Kështu ishin realizuar në tërësi objektivat sasiorë, ndërsa në aspektin cilësorë objektiva si transporti dhe mbrojtja e forcave kishin pasur vonesa në realizimin e tyre. Franca dhe Britania në një farë mënyre



mbetën disi të zhgënjyera nga realizimi i Qëllimeve të vendosura në Helsinki. Në 2004 u aprovua një objektiv tjetër primar i quajtur Headline Goal 2010. Shtetet anëtare angazhoheshin që të ishin të afta brenda vitit 2010, që të reagonin me aksione të shpejta dhe të vendosura mbi veprimet e nevojshme në raste krizash apo ndërhyrjesh ushtarake dhe civile. E gjithë kjo do të realizohej nga “grupe taktike”, të përbëra nga 1500-2000 ushtarë, të udhëhequra nga këshilla ushtarake kombëtare dhe multikombëtare. Sërish edhe pse arritjet nuk ishin të vogla në këtë drejtim, përsëri nuk munguan problemet, kështu nuk u vendosën qartë se cilët do të ishin institucionet mbikëqyrëse ndaj angazhimeve të secilit shtet dhe si do të ndiqej ecuria e tyre. Në 2009 Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët u fut në Traktatin e Lisbonës dhe rrjedhimisht festoi dhjetëvjetorin e saj.

Në disa këndvështrime Evropa po humbet shumë në aspektin e ndikimit të saj politik dhe ekonomik global. Përballë një Kine gjithnjë në rritje, një Brazili dhe Argjentine konkurruese dhe me një ekonomi ekspansioniste rajonale, si dhe Rusinë që kërkon të rigjej veten në arenën ndërkombëtare, situata duket shumë e paqartë. Këndvështrimi për rritjen e ndikimit evropian duket edhe më i zbehtë kur shtete si Turqia dhe Ukraina të gjendur në kufijtë e Evropës, lëkundën në mënyrë të paqartë për drejtimin që do të marrin në të ardhmen. E njëjta gjë ndodh edhe me Ballkanin, Serbia vijon të mbetet një “kunj” i fortë për të ardhmen e rajonit.

Shtetet anëtare vazhdojnë të veprojnë në mënyrë të pavarur mbi problemet e sigurisë së përbashkët. Në cilindo rast shtetet kanë zgjedhur të ruajnë një profil ndikimi dhe aktivizimi të ulët, po ashtu edhe Traktati i Lisbonës me shumë ngjalli dyshime sesa entuziazëm. Kjo

sjellje mund edhe të shpjegohet me një farë lodhjeje prej politikave të sigurisë të ndërmarra nga vendet anëtare (si dhe mbi rolin e BE-së), rezultati i të cilave nuk ishte i qartë dhe i perceptueshëm drejt. Fakti që Politika e Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët nuk dha rezultatet e pritura, ndikoi në opusin e përgjithshëm të këtyre vendeve mbi ruajtjen e perceptimit të BE-së më shumë si një institucion ekonomik-politik, për t'i lënë vend institucioneve të tjera ndërkombëtare si NATO që të luajnë rolin e tyre edhe në këtë fushë. Disa prej vendeve anëtare të BE-së janë të angazhuara prej vitesh në Afganistan dhe Irak, edhe pse ky rol mbetet i vogël në kuadër të Aleancës së Atlantikut, por gjithsesi është tregues se ata besojnë më shumë tek partnerët e vjetër se sa tek një Evropë e bashkuar por e paqartë.

Skenarët e ardhshëm dhe të mundshëm të ngjarjeve me shumë mundësi mund të anojnë drejt ndërhyrjeve me karakter humanitar e civil, gjë e cila i jep rëndësi dhe prioritet komponentëve të tillë si ndërhyrja dhe menaxhimi. Për këtë arsye pesha i bie të mbahet prej aktorëve shtetëror evropian të përfshirë në një integrim global ku BE-ja do të ketë pjesën e vet të mbështetjes mbi ngjarjet që mund të ndodhin. Këshilli i Evropës e hodhi hapin e parë në këtë drejtim me aprovimin e Deklaratës mbi rritjen dhe përforcimin e kapaciteteve (Declaration on Strengthening Capabilities) në 2008. Deklarata shfaqti një objektiv të ri ambicioz për BE: aftësia për të zhvilluar paralelisht dy misione atë të stabilizimit dhe atë të rindërtimit. Deklarata i kërkonte shteteve anëtare që në të njëjtën kohë të kërkonin dhe studionin mbi zhvillimin e kapaciteteve dhe teknikave për administrimin e burimeve dhe situatave.

Traktati i Lisbonës parashikonte një seri arritjesh dhe novacionesh për t'u

përshtatur prej BE-së në mënyrë që të arrihej një koherencë më e madhe politike ndërmjet vendeve në fushën e sigurisë së përbashkët. Parashikohej një mekanizëm i ri bashkëpunimi, i quajtur “Bashkëpunimi gradual në fushën e çështjeve të mbrojtjes” (Permanent Structured Cooperation in Defence Issues), që i krijonte mundësinë shteteve që kishin vullnetin e mirë për t'u organizuar ose bashkëpunuar në fushën e mbrojtjes së përbashkët. Pavarësisht kësaj klime që krijonte Traktati, vendet anëtare gjer më sot nuk kanë krijuar asnjë hapësirë bashkëpunimi në këtë fushë dhe nuk kanë marrë masa konkrete për të realizuar ndonjë objektiv të përbashkët lidhur me çështjet e mbrojtjes. Kjo vjen si rezultat i disa arsyeve, së pari se perspektivat politike dhe objektivat strategjike mbeten të paqarta. Idetë mund të jenë të shumta, por pak prej tyre janë koherente të cilat mund të konkretizohen. Po ashtu debatet akademike akoma nuk kanë

qartësuar se cilat mund të jenë përparësitë e një bashkëpunimi të mundshëm në fushën e mbrojtjes së përbashkët. Së dyti, se rruga drejt bashkëpunimit dhe mënyrat e realizimit të tij janë të shumta, mungon një vijë e qartë drejt së cilës vendet mund të orientohen. Së treti, mungojnë impenjimet ekonomike, të cilat do të bënin të mundshme realizimin e projekteve të bashkëpunimit. Kriza e fundit ekonomike i ka bërë vendet anëtare më të tërhequra dhe ka shtuar pasiguritë e tyre drejt projekteve të tilla që kërkojnë buxhete shtesë.

Përveç këtyre pikave ekzistojnë edhe paqartësi të tjera që kanë të bëjnë me debate më të hershme brenda BE-së. Një ndër këto është edhe koncepti i sovranitetit. Rezultatet e këtyre bashkëpunimeve janë të lidhura ngushtësisht me efektivitetin e sovranitetit të secilit prej vendeve anëtare. Pasi lind pyetja, sa të afta do të ishin këto vende të vepronin të vetme? Mbi këtë pyetje mund të nxirren konkluzione të qarta mbi politikën e ruajtjes së sovranitetit individual të vendeve anëtare, si dhe atij të BE nëse do të lind nevoja. Nga këndvështrimi ushtarak, mund të pyesim se çfarë janë të afta të bëjnë të vetme, vende si Gjermania, Italia, Franca, Zvicra ose Britania në situata krizash. Përgjigjet shkojnë drejt një jo-je të përbashkët, por asnjë nga vendet anëtare nuk kërkon ta mbush këtë vakum me një përgjigje përfundimtare, që do ta ballafaqonte secilin vend me një bashkëpunim të mundshëm ndërshtetëror. Faktorë të tillë si kriza financiare ose perspektivat demografike si dhe ndonjë krizë e mundshme natyrore, vetëm sa na e konfirmojnë atë çfarë thamë më sipër. Sovraniteti i kuptuar si aftësi veprimi, varet në radhë të parë nga aftësia për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar punët në nivel ndërshtetëror.

A.M.B.C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE



www.lidhjatregtareve.com



DYQANI I MISHIT "HALLALL"

- ✓ Tregton mish vici, qengji, qofte dhe sallameri të firmës "Meka", me shumicë dhe pakicë.
- ✓ Ofron qengja për kurbanë dhe akika.

Adresa: Rr. "Bedri Cullhaj", tek Goni, pranë Xhamisë së Kombinatit
Tel: 04 2350569; Cel: 0672050070
Email: agronxhepa@hotmail.com

DYQANI I MISHIT "HALLALL", Kombinat



PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



Jeni të mirëpritur!

Në dyqanin tonë do të gjeni:

- Produkte të firmës "Phenomenal"; vaj të farës së zezë (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimësh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zezë, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el -Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë xhamisë
"Dine Hoxha", Tiranë

Cel: 0672812607 / 0672821589